

Vendim nr. 61, datë 28.05.2026

(V-61/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 28.05.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 23 (F) 2025 të Regjistrimit Themeltar që u përket:

KËRKUES:

FATMIR LALA, VALBONA LALA, FATBARDH LALA, GRISELDA LALA, ORTIGO LALA, përfaqësuar nga avokati Ervin Demko.

SUBJEKT I INTERESUAR:

SHOQËRIA “PRO-PLAST” SH.P.K., përfaqësuar nga avokati Artan Zeneli, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-5053 (700), datë 04.12.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkesve Fatmir Lala, Valbona Lala, Fatbardh Lala, Griselda Lala dhe Ortigo Lala (*kërkuesit*),

të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Fatmir Lala dhe Valbona Lala janë prindërit dhe trashëgimtarët e radhës së dytë të djalit të tyre K.L., ndërsa Fatbardh Lala, Griselda Lala, Ortigo Lala janë vëllezërit e motra e tij. Shtetasi K.L., i mitur i moshës 15 vjeç në datën 26.08.2016 ka humbur jetën në mjediset e shoqërisë “Albantic” sh.p.k., ku punonte nëna e tij.

2. Subjekti i interesuar, shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k. është pronari i objektit disakatësh të ndodhur në Shkozë të Durrësit (ndërtesa e ish-plastikës), ku ushtronte veprimtarinë e saj edhe shoqëria “Albantic” sh.p.k. Me kontratën e datës 03.01.2015 godina/objekti i është dhënë me qira dy shoqërive “Albantic” sh.p.k. dhe “Derrigal” sh.p.k., për një afat kohor nga data 01.01.2015 deri në datën 31.12.2016.

3. Në datën 26.08.2016, rreth orës 14:00, Komisariati i Policisë Durrës është njoftuar se në mjediset e shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k., në gropën e ashensorit që shërbente për transportin e mallrave, kishin rënë shtetasi i mitur K.L. dhe shtetasi B.D. (punonjës). Si pasojë i mituri kishte gjetur menjëherë vdekjen, ndërsa shtetasi B.D. ishte dëmtuar rëndë. Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor i datës 30.08.2016 ka rezultuar se shkak i vdekjes për të miturin ka qenë shoku traumatik hemorragjik.

4. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në materialin e dërguar nga Komisariati i Policisë Durrës, ka regjistruar për këtë ngjarje kallëzim penal. Pas studimit të materialit kallëzues, me vendimin e datës 03.10.2016, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se nuk kishte elemente të veprës penale. Kërkuesja Valbona Lala e ka kundërshtuar vendimin për mosfillimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2019-348) 56/642, datë 25.01.2019, ka vendosur pranimin e ankimit, shfuqizimin e vendimit të prokurorit dhe urdhërimin për regjistrimin e procedimit penal e vijimin e hetimeve të nevojshme. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës fillimisht ka ngritur akuza penale vetëm ndaj administratorit të shoqërisë “Derrigal” sh.p.k. dhe administratorëve të shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k. për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar në nenet 289 dhe 25 të Kodit Penal. Në datën 05.10.2023 prokuroria ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale ndaj administratorëve të të dyja shoqërive. Për këtë kërkesë, gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 98, datë 25.07.2024, ka vendosur

plotësimin e hetimeve duke lënë afat 3 muaj kohë deri në datën 28.10.2024. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se gjykata e shkallës së parë i ka lënë disa detyra prokurorisë në drejtim të hetimeve më të plota, mes të tjerave, edhe për të arsyetuar rreth personave që janë marrë ose do të merren si të pandehur, pasi prokuroria kishte marrë si të pandehur vetëm administratorët e shoqërive. Pas plotësimit të detyrave të lëna nga gjykata, në datën 03.12.2025 prokuroria ka paraqitur kërkesa për dërgimin e çështjes penale në gjykim, duke marrë të pandehur edhe personat juridikë, shoqëritë “Pro-Plast” sh.p.k. dhe “Derrigal” sh.p.k. Sipas procesverbalit të seancës së kësaj date rezulton se gjykata e shkallës së parë e ka shtyrë seancën për në datën 23.12.2025, për shkak se çështja civile ka qenë në pritje për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata).

5. Për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga vdekja e djalit të tyre, në datën 12.04.2017 kërkesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke paditur shoqërinë “Pro-Plast” sh.p.k. me kërkesëpadi, me objekt: i) detyrimin e palës së paditur për të paguar shumën 5.000.000 lekë, për të gjitha dëmet reale pasurore dhe jopasurore, dëmin moral e ekzistencial të ardhur si pasojë e aksidentit të ndodhur në datën 26.08.2016; ii) marrjen e masës së sigurimit të padisë për bllokimin konservator të llogarive bankare ose të pasurive të paluajtshme/luajtshme, si garanci për ekzekutimin e saj.

6. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë është caktuar një ekspert inxhinier elektrik për evidentimin e shkaqeve të aksidentit. Sipas aktit të ekspertimit të datës 06.12.2017 u evidentua se: i) ashensori ishte ndërtuar në vitet 1977-1978; ii) nuk ka material që të vërtetojë se janë kryer inspektime periodike dhe se nuk ka certifikatë regjistrimi; iii) ashensori ka qenë jo në gjendje të mirë/i ndryshkur; iv) ashensori nuk duhej të punonte as për transportin e mallrave. Eksperti ka arritur në përfundimin se aksidenti ka ndodhur për shkak të mosplotësimit të kushteve teknike nga ana e shoqërive që e kishin në administrim ashensorin edhe për shkak të futjes të një personi të paautorizuar.

7. Gjithashtu, është caktuar edhe një vlerësues për dëmet në sigurime, për dëme shëndetësore dhe materiale, i cili me aktin e ekspertimit të datës 17.05.2018 ka përcaktuar vlerat e mundshme të dëmshpërblimit. Për këtë arsye, në seancën e datës 31.05.2018, kërkesit kanë shtuar objektin e kërkesëpadisë me këtë përmbajtje: i) detyrimin e shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k. të paguajë në favor të kërkesve shumën 66.352,820 lekë, në bazë të aktit të ekspertimit të datës 17.05.2018, shumë e cila konsiston në të gjitha dëmet reale pasurore dhe jopasurore, dëmin moral dhe ekzistencial të ardhur si pasojë e aksidentit të ndodhur në mjediset e firmës “Pro-Plast” sh.p.k., me pasojë vdekjen e shtetasit K.L.; ii) marrjen e masës së sigurimit të padisë për bllokimin konservator të llogarive bankare ose pasurive të luajtshme ose të paluajtshme për shumën objekt detyrimi.

8. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2018-3363) 1113, datë 03.07.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka arsyetuar se shtetasi K.L. ka gjetur vdekjen në mënyrë aksidentale nga përdorimi i ashensorit të mallrave në mjediset e shoqërisë “Albantic” sh.p.k. Në datën 26.08.2016, kur ka ndodhur aksidenti, mjedisi administrohej nga kjo shoqëri. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, në datën 17.05.2018, kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për të thirrur në gjykim, në cilësinë e palës së paditur, edhe dy shoqëritë, “Derrigal” sh.p.k. dhe “Albantic” sh.p.k., pasi padia ishte ngritur vetëm ndaj shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k., por gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar kërkesën me arsyetimin se kërkuesit kanë qenë në dijeni të situatës juridike që prej fillimit të gjykimit. Tashmë ishin zhvilluar 15 seanca gjyqësore dhe gjykimi ishte në përfundim. Në lidhje me themelin e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se, sipas kontratave të qirasë, qiradhënësi i jepte të drejtë qiramarrësit të bënte punime plotësuese në objekt pa prishur anën funksionale të tij. Qiradhënësja, shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., i jepte qiramarrëses “Derrigal” sh.p.k. të drejtën për të montuar një ashensor me shpenzimet e saj për ngritjen e mallrave brenda kushteve teknike të objektit me parametrat e nevojshëm, pa prishur anën konstruktive të objektit. Ndërsa sipas kontratës së qirasë me shoqërinë “Albantic” sh.p.k., kjo e fundit kishte të drejtë të bënte punime plotësuese, pa prishur anën funksionale të objektit. Afati i kontratave të qirasë ishte deri në datën 31.12.2016 dhe aksidenti ka ndodhur në datën 26.08.2016, në kohën kur mjedisi administrohej nga shoqëritë qiramarrëse.

9. Pas ankimit të kërkuesve, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2022-367 (97), datë 23.02.2022, ka ndryshuar vendimin nr. (11-2018-3363) 1113, datë 03.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ka pranuar padinë. Në këtë kuadër, ajo ka detyruar shoqërinë “Pro-Plast” sh.p.k. të dëmshpërblejë paditësit për dëmin pasuror dhe jopasuror (dëmin ekzistencial), duke njohur në favor të prindërve të viktimës, Fatmir Lala dhe Valbona Lala, dëmshpërblimin për humbjen e jetës të të birit, si dhe shpenzimet e varrimit, ndërsa në favor të secilit prej familjarëve (Fatmir Lala, Valbona Lala, Fatbardh Lala, Griselda Lala dhe Ortigo Lala) ka akorduar dëmshpërblim si për dëmin pasuror, ashtu edhe për dëmin jopasuror, në shumat e përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

10. Gjykata e apelit ka arsyetuar se, megjithëse sipas kontratave të qirasë shoqëria “Derrigal” sh.p.k. kishte të drejtë të montonte një ashensor të ri, ajo nuk kishte marrë përsipër detyrimet për gjendjen teknike të ashensorit ekzistues. Duke iu referuar nenit 623 të Kodit Civil (KC), gjykata ka vlerësuar se pronarja e ndërtesës, shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., mbante përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga e meta e ashensorit të instaluar në objektin në pronësi të saj. Megjithatë, për shkak se objekti i ishte dhënë me qira dy shoqërive të tjera, gjykata ka çmuar se të tria shoqëritë mbanin përgjegjësi solidare për dëmin e shkaktuar. Ajo ka arsyetuar

gjithashtu se shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k. kishte dijeni për gjendjen teknike të ashensorit dhe, megjithëse kishte mundësi të parashikonte pasojat që mund të vinin, nuk kishte marrë masa për t’i parandaluar ato. Sipas gjykatës, kjo shoqëri nuk arriti të provonte gjatë gjykimit se aksidenti kishte ndodhur si pasojë e ndonjë veprimi ose mosveprimi tjetër (*shih faqen 13 të vendimit të gjykatës së apelit*).

11. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., në datën 26.03.2022, ka paraqitur rekurs. Në datën 25.03.2022 kjo shoqëri ka paraqitur edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, për të cilën Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 53, datë 27.04.2022, ka vendosur pranimin dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në datën 29.03.2022 kërkesit kanë paraqitur kundërrekurs dhe në datën 27.11.2024 kanë depozituar në Gjykatën e Lartë shpjegimet me shkrim. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-5053 (700), datë 04.12.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 10-2022-367 (97), datë 23.02.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. (11-2013-3363) 1113, datë 03.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit, në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka adresuar në përputhje me ligjin përgjegjësinë e subjektit që gëzon ndërtesën nëpërmjet një kontrate qiraje, në raport me dëmet e shkaktuara nga objektet e lidhura në mënyrë të qenësishme me ndërtesën. Kolegji Civil ka çmuar të bazuar analizën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vlerësuar për mungesën e veprimeve ose të mosveprimeve të paligjshme nga ana e shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k. dhe të lidhjes shkakësore me dëmin e ardhur. Sipas Gjykatës së Lartë, përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të metat e produktit i përket subjektit që ka në posedim/gëzim ndërtesën ku produkti/ashensori është i instaluar, për sa kohë ai ka detyrimin e garantimit të përputhshmërisë së produktit/instalimit me kërkesat e detyrueshme të sigurisë, mbi të cilin, sipas kontratës së qirasë, ushtron pushtetin e gëzimit efektiv. Sipas Gjykatës së Lartë, përgjegjësia e punëdhënësit, e përcaktuar në nenin 3, pika 24, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” (*ligji nr. 10489/2011*) e parë edhe në raport me përgjegjësinë për dëmtimin në punë të punëmarrësit, është e lidhur vetëm me dëmet që u shkaktohen punëmarrësve në ngarkim të tij. Ndërkohë, në rastin konkret, jemi përpara dëmit që i shkaktohet një të treti që nuk është punëmarrës, por përdorues rastësor i këtij instalimi (*shih faqet 19-20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

12. Kërkesit në datën 24.07.2025 i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 24.10.2025, gjatë shqyrtimit paraprak, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se gjatë procesit të gjyqësor është cenuar:

13.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

13.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të kompetencave të saj si gjykatë ligji, duke kryer një vlerësim tërësisht të ndryshëm, nga gjykata e apelit, të të njëjtave fakte dhe duke arritur në përfundimin se vendimi i saj duhej ndryshuar jo për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, por për shkak të vlerësimit të ndryshëm të provave. Gjykata e Lartë, duke i rikualifikuar faktet bazuar në vlerësimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë, ka një vlerësim të mëtejshëm të tyre që nuk është në pajtim me funksionin e saj si gjykatë ligji. Gjykata e Lartë, edhe pse nuk ka gjetur zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit, e ka prishur vendimin e saj duke u bazuar vetëm në vlerësimin e provave dhe të fakteve nga gjykata e shkallës së parë, sipas së cilës, në datën 28.06.2016, kur ka ndodhur ngjarja, ka qenë në fuqi kontrata e qirasë dhe mjedisi administrohej nga pala qiramarrëse, ndaj pronari i ndërtesës nuk ka përgjegjësi. Në rastin konkret, gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për çështje të faktit, për pasojë edhe për sa i përket zbatimit të ligjit material në përcaktimin e përgjegjësisë.

13.1.2. *Së drejtës së aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit*, pasi mënyra e disponimit nga Gjykata e Lartë u ka mohuar kërkuesve të drejtën për të kërkuar përgjegjësinë dhe për shpërblimin e dëmit për vdekjen e të afërmit të tyre, aq më tepër që ka kaluar një periudhë kohe shumë e gjatë nga momenti i ndodhjes së faktit. Në çdo rast nëse Gjykata e Lartë do të vlerësonte se hetimi gjyqësor nuk ishte kryer i plotë dhe në përputhje me ligjin dhe çështja kishte nevojë për hetime të mëtejshme ose rivlerësim të provave për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore për fuqinë e tyre provuese duhet ta kthente çështjen për rishqyrtim dhe jo të linte në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka cenuar *të drejtën e aksesit*, pasi kërkesa për shtimin e ndërgjyqësisë nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, duke u bazuar në argumente joligjore dhe në kundërshtim me nenin 161, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit “*Në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur*”. Vendimi i Gjykatës së Lartë, duke anuluar pasojat e një vendimi gjyqësor të

formës së prerë, sikurse është ai i gjykatës së apelit, ka cenuar edhe *parimin e sigurisë juridike*.

13.2. *E drejta e pronës*, pasi Gjykata e Lartë, pas një procesi të parregullt ligjor, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuësve, duke u mohuar atyre edhe të drejtën e dëmshpërblimit nga aksidenti, me pasojë vdekjen e djalit të tyre.

14. **Subjekti i interesuar, shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k.,** ka prapësuar:

14.1. Për cenimin e së drejtës për procesin e rregullt ligjor:

14.1.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi vetëm fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar kërkesëpadinë nuk lë dyshime për cenimin e kësaj të drejte. Fakti që Gjykata e Lartë brenda kompetencave të saj, e ndodhur midis me dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që kanë interpretuar ndryshe ligjin dhe kanë vlerësuar ndryshe provat për përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit, duke e vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk ka sjellë cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Kërkuësit nuk kanë identifikuar asnjë provë ose fakt që është interpretuar ndryshe nga Gjykata e Lartë. Duke pasur parasysh natyrën e gjykimit që zhvillon ajo gjykatë, është i pashmangshëm referimi në prova e në fakte për të interpretuar ligjin në përputhje me to.

14.1.2. *Pretendimi për të drejtën e aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit*, nuk është i bazuar, sepse Gjykata e Lartë ka arsyetuar vendimin në respektim të standardeve kushtetuese. Për më tepër, kërkuësit nuk kanë arritur të sjellin argumente konkrete se Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimmarrjes së saj, ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike.

14.2. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës* nuk është i bazuar, pasi pretendimi është i lidhur me kërkimet e tjera të sipërcituara, për të cilat kërkuësit nuk kanë arritur të evidentojnë dhe të paraqesin përpara Gjykatës argumente konkrete. Çështja e dëmshpërblimit është vënë në diskutim gjatë të gjithë procesit gjyqësor dhe kërkuësit kanë pasur mundësi për të paraqitur argumentet e tyre e të debatonin rreth tyre.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

15. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Në zbatim të këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se kërkuessit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse kanë qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në këtë Gjykatë.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuessit i janë drejtuar asaj pas përfundimit të procesit gjyqësor të përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe pasi kanë shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjete të tjera juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Lidhur me legjitimitetin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar se ankimi kushtetues individual duhet të paraqitet brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, kërkuessit e përmbushin edhe këtë kriter, pasi vendimi i kundërshtuar mban datën 04.12.2024, ndërsa sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë ai është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 25.03.2025. Duke qenë se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 24.07.2025, ai konsiderohet se është depozituar brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Lidhur me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike, si dhe së drejtës së pronës.

20. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e parimit të sigurisë juridike*, Gjykata vëren se kërkuessit kanë parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka anuluar pasojat e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Për të njëjtin argument kërkuessit kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës.

21. Për sa u përket të drejtave të fituara, si elemente të parimit të sigurisë juridike, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 23, datë 08.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 12, datë 17.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse në lidhje me parimin *res judicata*, Gjykata ka theksuar se në aspektin formal e procedural gjë e gjykuar nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë detyruese të vendimit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa kohë ajo ka disponuar për detyrimin e palës së paditur/shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k. për pagimin e një dëmshpërblimi në favor të kërkuësve, për shkak të humbjes së jetës të të afërmit të tyre dhe ekzekutimin e tij si titull ekzekutiv nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, konsiderohet si vendim i formës së prerë në kuptim të fuqisë ekzekutive. Megjithatë, ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*) për sa i përket zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes mes palëve, për sa kohë që palët kanë përdorur mjetet e zakonshme të ankimit (pala e paditur ka paraqitur rekurs dhe kërkuësit/paditësit kundërrekurs), duke e bërë në këtë mënyrë Gjykatën e Lartë kompetente për të shqyrtuar çështjen dhe për të vendosur për to. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa parashtrojnë kërkuësit, nuk ka një vendim gjyqësor të paankimueshëm që të ketë vendosur përfundimisht për dëmshpërblimin, ndaj pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës janë haptazi të pabazuara.

23. Pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit substancial dhe të standardit të arsyetimit të vendimit, kërkuësit e kanë parashtruar edhe në drejtim të faktit që mënyra e disponimit nga Gjykata e Lartë u ka mohuar atyre të drejtën për të kërkuar përgjegjësinë dhe shpërblimin e dëmit, si pasojë e aksidentit ku ka humbur jetën i afërmi i tyre. Sipas kërkuësve, Gjykata e Lartë nuk mund të linte në fuqi vendimin e gjykatës shkallës së parë, për sa kohë nuk ka rezultuar që gjykata e apelit të ketë zbatuar gabim ligjin material në raport me faktet e pranuar. Gjykata vlerëson se argumentet e paraqitura për këtë pretendim janë të ndërlidhura me pretendimin tjetër të tyre, për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, ku, sipas kërkuësve, Gjykata e Lartë ka rikualifikuar faktet duke vepruar në tejkalim të kompetencave të saj.

24. Në vijim të argumenteve të parashtruara nga kërkuësit, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm kur mosmarrëveshja mund të zgjidhet mbi bazën e të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit, të cilat përbëjnë bazën

e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Në këto kushte, duke pasur parasysh se kontrolli i Gjykatës së Lartë fokusohet vetëm në ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta (*shih vendimet nr. 36, datë 30.04.2024; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 10, datë 03.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata do të vlerësojë pretendimet e kërkuësve në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, si dhe pasojat e mundshme të tyre në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

25. Kërkuësit, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se Gjykata e Lartë, me qëndrimin e saj, u ka mohuar të drejtën për të kërkuar përgjegjësinë dhe shpërblimin si pasojë e humbjes së jetës së djalit të tyre të shkaktuar nga të metat që lidhen me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tij. Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e gjykatës së apelit jo për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material ose procedural, por duke ripërcaktuar faktet e ngjarjes. Po sipas kërkuësve, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kërimit për shtimin e ndërgjyqësisë në kushtet kur gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar atë në mënyrë të padrejtë.

26. Subjekti i interesuar, shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të saj, e ndodhur mes dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që kanë interpretuar ndryshe ligjin dhe që kanë vlerësuar ndryshe provat për përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit. Kërkuësit nuk kanë arritur të identifikojnë asnjë provë ose fakt që është interpretuar ndryshe nga Gjykata e Lartë, e cila edhe për shkak të natyrës së gjykimit që zhvillon, duhet t’u referohet provave për të interpretuar ligjin në përputhje me to.

27. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç janë e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ripohon se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 14, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Nën dritën e garancive të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, duke pasur parasysh standardet kushtetuese të mësipërme dhe në referim të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruara nga kërkuesit, Gjykata do të analizojë nëse interpretimi e zbatimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, përmban ose jo elemente arbitrariteti, si dhe nëse ajo gjykatë ka gjykuar çështjen duke mos krijuar dyshime në drejtimin edhe të respektimit të kompetencave të saj.

30. Sikurse u parashtrua në rrethanat e rastit në shqyrtim, çështja lidhet me kërkimin e shpërblimit si pasojë e humbjes së jetës së djalit të mitur të kërkuesve nga rënia në gropën e një ashensori, duke përcaktuar edhe personat përgjegjës për shkaktimin e aksidentit. Gjykata konstaton se kërkuesit e kanë bazuar kërkimin e tyre në nenin 623 të KC-së, në ligjin nr.10489/2011, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”” (*VKM-ja nr. 1056/2015*). Konkretisht, në pikën 24 të nenit 3 të ligjit nr.10489/2011 parashikohet se personi përgjegjës i instalimit të vënë në shërbim për të tretët ose për publikun është titullari i së drejtës së pronësisë për instalimin, personi që ka në gëzim të përkohshëm instalimin, nëse ky i fundit ka detyrimin e garantimit të përputhshmërisë së instalimit me kërkesat e detyrueshme të sigurisë, në bazë të një marrëveshjeje me pronarin ose një akti administrativ, punëdhënësi për

instalimin e vendosur në vendin e punës. Ndërsa në pikën 2.2. të VKM-së nr. 1056/2015 parashikohet se certifikatë regjistrimi konsiderohet ajo e lëshuar nga struktura përgjegjëse për regjistrimin e një ashensori.

31. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për çështjet e faktit dhe, për pasojë, edhe për sa i përket zbatimit të ligjit material në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit. Konkretisht, gjatë gjykimit në shkallën e parë është arsyetuar se në datën 26.08.2016, kur ka ndodhur aksidenti, mjedisi administrohej nga shoqëritë qiramarrëse “Albantic” sh.p.k. dhe “Derrigal” sh.p.k. dhe, për pasojë, ndaj subjektit të interesuar (shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., pronare e ndërtesës) nuk provoheshin në mënyrë kumulative katër elementet sipas nenit 608 të KC-së për përcaktimin e dëmit. Sipas gjykatës së shkallës së parë, nuk provohet se subjekti i interesuar t’u kishte shkaktuar dëm kërkuar ose që ai (subjekti i interesuar) të ketë kryer veprime ose mosveprime të paligjshme, si dhe nuk rezulton të ketë lidhje shkakësore midis veprimit dhe mosveprimit të subjektit të interesuar dhe dëmit të ardhur. Nëpërmjet kontratës së qirasë shoqëria “Pro Plast” sh.p.k., në cilësinë e pronares të pasurisë, në vitin 2015 i ka dhënë me qira shoqërisë “Albantic” sh.p.k. objektin ku ka ndodhur ngjarja, duke përcaktuar se pala qiradhënëse i jep të drejtën palës qiramarrëse të bëjë punime plotësuese në objekt pa prishur anën funksionale të tij, ndërsa shoqëria tjetër “Derrigal” sh.p.k. kishte të drejtë të montonte një ashensor për ngritjen e mallrave, sipas kushteve teknike. Sipas gjykatës së shkallës së parë, në momentin kur ka ndodhur ngjarja kontrata e qirasë ka qenë në fuqi dhe mjedisi administrohej nga palët qiramarrëse (dy shoqëritë e tjera). I ndjeri K.L. ka gjetur vdekjen në mënyrë aksidentale, për shkak të përdorimit nga ana e tij të një ashensori mallrash. Ai është futur në mjediset e shoqërisë “Albantic” sh.p.k. i shoqëruar nga nëna e tij Valbona Lala, e cila punonte si sanitare në këtë shoqëri. Edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në përfundim të hetimeve ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se nuk ka elemente të veprës penale ndaj subjektit të interesuar. Po kështu, kjo gjykatë nuk ka pranuar kërkesën e kërkuarve për të thirrur në gjykim, në cilësinë e palës së paditur, edhe dy shoqëritë “Derrigal” sh.p.k. dhe “Albantic” sh.p.k., me arsyetimin se kërkuarët kanë qenë në dijeni të situatës juridike prej fillimit të gjykimit dhe tashmë ishin zhvilluar 15 seanca gjyqësore dhe gjykimi ishte në përfundim.

32. Ndërsa gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se, sipas parashikimit kontraktor, shoqëria “Derrigal” sh.p.k. kishte të drejtën e montimit të një ashensori të ri, por nuk kishte marrë përsipër garantimin e përputhshmërisë së ashensorit me kërkesat e detyrueshme të sigurisë. Gjithashtu, referuar edhe nenit 623 të KC-së, shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., si pronare e ndërtesës, ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga të metat e ashensorit që është i instaluar në ndërtimin në pronësi të saj. Meqenëse objekti u është dhënë me qira dy shoqërive të tjera,

“Derrigal” sh.p.k dhe “Albantic” sh.p.k., sipas gjykatës së apelit të tria shoqëritë kanë përgjegjësi solidare në shkaktimin e dëmit. Prandaj pala e paditur, shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., sipas paragrafit të dytë të nenit 623 dhe paragrafit të parë të nenit 627 të KC-së, mund të kërkojë nga secila prej shoqërive pjesën e saj, në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilës dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura, përmes padisë së regresit. Gjykata e apelit ka analizuar elementet e parashikuara në nenin 608 të KC-së. Konkretisht, për elementin “faj” ka arsyetuar se shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k. ka pasur mundësinë e parashikimit të pasojave që mund të vinin prej saj dhe me ndërgjegje, nuk ka penguar ardhjen e pasojës; për lidhjen shkakësore, shoqëria nuk ka arritur të provojë që aksidenti ka ardhur si pasojë e një veprimi/mosveprimi tjetër, si dhe për dëmin e shkaktuar në formën e dëmit pasuror dhe jopasuror. Gjykata e apelit në analizën për mosveprimin e paligjshëm i është referuar edhe pikës 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011, si dhe pikës 2.2. të VKM-së nr. 1056/2015.

33. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen mbi rekursin e shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k. dhe kundërrekursin e kërkuësve. Në analizë të kushteve ligjore të përgjegjësisë civile (ekzistencës së paligjshmërisë së veprimit/mosveprimit, dëmit, fajit dhe lidhjes shkakësore mes veprimit e pasojës së ardhur për përcaktimin e përgjegjësisë), për sa i përket përgjegjësisë jashtëkontraktore, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se referuar nenit 623 të KC-së, pronari i një ndërtese është përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve nga të metat në struktura murale, si dhe në impiantet ose objektet e inkorporuara në mënyrë të përhershme në këto struktura. Sipas Gjykatës së Lartë, kur dëmi vjen nga një objekt, sikundër është ashensori, për shkak të karakteristikave të tij si një send në përdorim të vazhdueshëm dhe i prirur drejt një marzhi të lartë amortizimi, te qiramarrësi, krahas përgjegjësisë së mirëmbajtjes, transferohet edhe përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga ky send. Në rastin kur ndërtesa jepet me qira dhe si rezultat i përdorimit të objekteve të lidhura ngushtësisht me ndërtesën shkaktohet dëm, është posedimi i vazhdueshëm që “zhvendos” te qiramarrësi detyrimin për t’u përgjigjur për dëmin e shkaktuar (*shih paragrafin 26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas Gjykatës së Lartë, në referim të pikës 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011, përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga një instalim (sikundër është ashensori) sipas rastit, i takon titullarit të së drejtës së pronësisë mbi produktin ose personit që ka në gëzim të përkohshëm produktin, nëse ky i fundit mbi bazën e një marrëveshjeje me pronarin, ka marrë përsipër detyrimin e garantimit të përputhshmërisë së produktit me kërkesat e detyrueshme të sigurisë. Në momentin e ndodhjes së aksidentit përgjegjëse kanë qenë shoqëritë qiramarrëse “Albantic” sh.p.k. dhe “Derrigal” sh.p.k. Sipas Gjykatës së Lartë, qiramarrësi, duke qenë në dijeni të parregullsisë së ashensorit ekzistues, ka dakordësuar me pronaren e ndërtesës, shoqërinë “Pro-Plast” sh.p.k., që të ndërtonin një ashensor të ri, fakt për të cilin pronarja ka dhënë miratimin e tij. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se gjykata e apelit, në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka adresuar në përputhje

me ligjin përgjegjësinë e subjektit që gëzon ndërtesën nëpërmjet një kontrate qiraje, në raport me dëmet e shkaktuara nga objektet e lidhura në mënyrë të qenësishme me ndërtesën (*shih paragrafët 29-32 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

34. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se, ndonëse Gjykata e Lartë e ka bazuar analizën e saj mbi të njëjtat fakte dhe prova të administruara gjatë gjykimit në gjykatat e faktit, përfundimi i saj për përjashtimin e përgjegjësisë së pronares mbështetet në një interpretim të kontratave të qirasë, i cili nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e tyre.

35. Në veçanti, Gjykata vëren se nga kontratat e qirasë nuk rezulton të jetë parashikuar ndonjë klauzolë, sipas së cilës qiramarrësja kishin marrë përsipër detyrimin për garantimin e përputhshmërisë së ashensorit ekzistues me kërkesat e detyrueshme të sigurisë, në kuptim të pikës 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011. Po kështu, rezulton se ashensori ku ndodhi aksidenti ishte pjesë e godinës që prej vitit 1977 dhe jo një instalim i ri i realizuar nga qiramarrësja. Megjithatë, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se përgjegjësia ishte transferuar te qiramarrësja vetëm mbi bazën e posedimit dhe përdorimit të godinës, pa identifikuar bazën kontraktore ose ligjore që justifikonte një përfundim të tillë. Thënë ndryshe, ajo është mjaftuar me konkluzionin se posedimi dhe përdorimi i ndërtesës nga qiramarrëset sillnin zhvendosjen e përgjegjësisë për dëmin, pa analizuar nëse ky përfundim mbështetej në parashikimet konkrete të kontratave të qirasë, si dhe në rrethanën se ashensori përbënte një pjesë ekzistuese të godinës në pronësi të shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k. dhe se pronarja ka pasur mundësinë e parashikimit të pasojave që mund të vinin prej kësaj situate në kushtet kur nuk ishte montuar një ashensor i ri nga shoqëria qiramarrëse.

36. Gjykata vëren gjithashtu se vetë Gjykata e Lartë ka pranuar se pronarja kishte dijeni për gjendjen e ashensorit ekzistues, pasi qiramarrësja kishte dakordësuar me të për ndërtimin e një ashensori të ri. Megjithatë, ajo nuk ka analizuar ndikimin që kjo rrethanë kishte në përcaktimin e përgjegjësisë së pronares dhe as nuk ka shpjeguar se përse miratimi për instalimin e një ashensori të ri konsiderohej i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se detyrimi për garantimin e sigurisë së ashensorit ekzistues ishte transferuar te qiramarrësit.

37. Bazuar në këtë analizë, Gjykata çmon se interpretimi që Gjykata e Lartë u ka bërë kontratave të qirasë nuk harmonizohet me përmbajtjen objektive të tyre, në kuptimin që nuk analizon në mënyrë shteruese detyrimet e të gjitha palëve në kontratat e qirasë, si dhe nuk mbështetet në faktet e pranuar prej saj dhe nga gjykatat e faktit. Në këto kushte, përfundimi për përjashtimin e përgjegjësisë së pronares nuk është rezultat i një analize të plotë dhe logjike të lidhur të dispozitave kontraktore dhe ligjore të zbatueshme.

38. Gjykata vëren gjithashtu se në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se përgjegjësia për dëmin zhvendosej te shoqëritë qiramarrëse, ndërsa nuk ka shpjeguar se përse, pavarësisht këtij përfundimi, e ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së

shkallës së parë, i cili kishte refuzuar thirrjen e këtyre shoqërive në gjykim. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit të kërkuësve për refuzimin, nga gjykata e shkallës së parë, të kërkesës për thirrjen në gjykim edhe të dy shoqërive qiramarrëse. Po kështu, Gjykata e Lartë, edhe pse ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, nuk ka analizuar se përse është i gabuar arsyetimi i asaj gjykate (së apelit) në lidhje me përgjegjësinë solidare të të tria shoqërive (asaj pronare të godinës dhe dy shoqërive qiramarrëse) në shkaktimin e dëmit.

39. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk plotëson standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Interpretimi jo i plotë i kontratave të qirasë dhe mosdhënia e një përgjigjeje për përgjegjësinë solidare të shoqërive ka çuar në një zbatim të ligjit që nuk mbështetet në elementet objektive të çështjes dhe, për pasojë, në një vendimmarrje që paraqet elemente arbitrariteti në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të jurisprudencës kushtetuese. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

40. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-5053 (700), datë 04.12.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.05.2026

Shpallur më 21.07.2026

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkesve Fatmir Lala, Valbona Lala, Fatbardh Lala, Griselda Lala dhe Ortigo Lala, me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-5053 (700), datë 04.12.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, ne, gjyqtarët Sandër Beci, Ilir Toska dhe Asim Vokshi, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar, mbështetur në argumentet që do të parashtrojmë në vijim.

2. Përpara analizës së pretendimeve të ngritura në ankimin kushtetues individual të kërkesve, e vlerësojmë të nevojshme të paraqesim, në mënyrë të përmbledhur, procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë. Kështu, kërkesit kanë vënë në lëvizje procesin gjyqësor me anë të një padie për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror jashtëkontraktor të shkaktuar nga humbja e jetës të të afërmit të tyre të mitur, si pasojë e një aksidenti të ndodhur gjatë përdorimit të ashensorit të mallrave të instaluar në mjediset e një ndërtese të ish-ndërmarrjes së Plastikës, Shkozet, Durrës, në pronësi të subjektit të interesuar, shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k. Në kohën e ngjarjes, disa nga këto mjedise u ishin dhënë me qira shoqërive “Albantic” sh.p.k. dhe “Derrigal” sh.p.k. Padinë e tyre kërkesit e kanë drejtuar vetëm kundër shoqërisë pronare të objektit, e cila ka kundërshtuar legjitimitimin e saj pasiv, duke pretenduar se mjediset ku kishte ndodhur aksidenti ishin në posedimin dhe në administrimin e shoqërive qiramarrëse. Ajo është mbështetur edhe në klauzolën e kontratës së qirasë së lidhur me shoqërinë “Derrigal” sh.p.k., sipas së cilës kësaj të fundit i ishte dhënë e drejta të montonte, me shpenzimet e veta, një ashensor të ri për ngritjen e mallrave, duke pretenduar se kjo rrethanë tregonte dijeninë e qiramarrësit për parregullsinë e ashensorit ekzistues. Gjatë gjykimit, subjekti i interesuar ka kërkuar disa herë që në cilësinë e të paditurve të thirreshin edhe dy shoqëritë qiramarrëse, ndërsa kërkesit fillimisht kanë mbajtur qëndrimin se ndërgjyqësia ishte ndërtuar drejt. Më pas, në fazën përfundimtare të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, edhe kërkesit kanë kërkuar thirrjen e këtyre shoqërive në cilësinë e të paditurve, por kërkesa e tyre është rrëzuar, me arsyetimin se ata kishin qenë në dijeni të situatës juridike që në fillim të procesit, se nuk ishin paraqitur fakte ose rrethana të reja dhe se gjykimi, pas zhvillimit të 15 seancave dhe administrimit të provave, ishte në përfundim.

3. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë e ka rrëzuar padinë e kërkesve, duke vlerësuar se nuk provoheshin veprime ose mosveprime të paligjshme të shoqërisë pronare të ndërtesës dhe as lidhja shkakësore ndërmjet sjelljes së saj dhe dëmit të ardhur. Sipas kësaj gjykate, në kohën e aksidentit kontratat e qirasë ishin në fuqi dhe mjediset ku kishte ndodhur ngjarja ishin në administrimin e shoqërive qiramarrëse. Nga përmbajtja e këtyre kontratave rezultonte se qiramarrësve u ishte njohur e drejta të kryenin punime plotësuese në objekt,

ndërsa shoqërisë “Derrigal” sh.p.k. edhe e drejta të montonte, me shpenzimet e veta, një ashensor për ngritjen e mallrave. Në këto rrethana, gjykata ka çmuar se vetëm cilësia e shoqërisë “Pro-Plast” sh.p.k., si pronare e objektit, nuk mjaftonte për t’ia ngarkuar asaj përgjegjësinë për dëmin. Për rrjedhojë, ndonëse ekzistenca e dëmit nuk vihej në diskutim, nuk provoheshin në mënyrë kumulative kushtet e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore të parashikuara nga neni 608 i KC-së, në veçanti sjellja e paligjshme e subjektit të interesuar dhe lidhja shkakësore e saj me pasojën e ardhur.

4. Pas ankimit të kërkuësve, çështja është shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pranimin e padisë dhe detyrimin e subjektit të interesuar për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror të pësuar nga kërkuësit. Gjkata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se subjekti i interesuar legjitimohej në mënyrë pasive, pasi ishte pronar i ndërtesës dhe i ashensorit të instaluar në të, ndaj, në kuptim të nenit 623 të KC-së, mbante përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga të metat e lidhura me ndërtimin ose mirëmbajtjen e tyre. Sipas saj, parashikimi i kontratës së qirasë, që i njihte shoqërisë “Derrigal” sh.p.k. të drejtën për të montuar një ashensor të ri, nuk nënkuptonte se kjo shoqëri kishte marrë përsipër detyrimin për garantimin e përputhshmërisë së ashensorit ekzistues me kërkesat e detyrueshme të sigurisë. Për rrjedhojë, në mungesë të një marrëveshjeje që t’ia kalonte këtë detyrim qiramarrësit, subjekti i interesuar, si titullar i së drejtës së pronësisë mbi instalimin, konsiderohej personi përgjegjës në kuptim të ligjit nr. 10489/2011 dhe VKM-së nr. 1056/2015. Në mbështetje të aktit të ekspertimit, gjykata e apelit ka vlerësuar se ashensori përdorej jashtë kushteve teknike, nuk ishte mirëmbajtur prej vitesh dhe nuk iu ishte nënshtruar kontrolleve periodike, ndaj mosveprimi i paligjshëm i subjektit të interesuar konsistonte në mosmarrjen e masave të nevojshme të sigurimit teknik.

5. Gjkata e apelit ka vlerësuar gjithashtu se subjekti i interesuar kishte dijeni për gjendjen teknike të ashensorit, çka provohej, ndër të tjera, edhe nga parashikimi kontraktor për lejimin e instalimit të një ashensori të ri, por nuk kishte marrë masa për të parandaluar ardhjen e pasojës. Për rrjedhojë, ajo ka vlerësuar se plotësoheshin kushtet e përgjegjësisë civile jashtëkontraktore, përfshirë lidhjen shkakësore, pasi vdekja e të miturit ishte pasojë e drejtpërdrejtë e mosveprimit të subjektit të interesuar, i cili nuk kishte provuar se aksidenti ishte shkaktuar nga ndonjë veprim ose mosveprim tjetër. Megjithatë, duke qenë se mjediset u ishin dhënë me qira shoqërive “Albantic” sh.p.k. dhe “Derrigal” sh.p.k., gjykata e apelit, duke iu referuar nenit 626 të KC-së, ka vlerësuar se të tria shoqëritë mbanin përgjegjësi solidare për dëmin e shkaktuar kërkuësve. Po kështu, në mbështetje të paragrafit të dytë të nenit 623 dhe paragrafit të parë të nenit 627 të KC-së, gjykata e apelit i ka njohur subjektit të interesuar të drejtën që, me padi regresi, t’u kërkonte shoqërive qiramarrëse pjesën e përgjegjësisë që u takonte, në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilës dhe tërësinë e pasojave të ardhura.

6. Në vijim, për rekursin e subjektit të interesuar dhe kundërrekursin e kërkuësve, çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në analizën e saj, Gjykata e Lartë është ndalur fillimisht në interpretimin e nenit 623 të KC-së, duke vlerësuar se pronari i ndërtesës, si rregull, përgjigjet ndaj të tretëve për dëmet e shkaktuara nga të metat e elementeve strukturore të saj, si dhe të impianteve ose të objekteve të inkorporuara në mënyrë të përhershme në këto struktura, të cilat nuk kushtëzohen nga përdorimi i zakonshëm i sendit. Megjithatë, sipas saj, kur ndërtesa është dhënë me qira dhe dëmi shkaktohet nga përdorimi i objekteve të lidhura ngushtësisht me të, posedimi faktik dhe i vazhdueshëm mund të zhvendosë te qiramarrësi detyrimin për t'u përgjigjur për dëmin. Në veçanti, sipas saj, për një send si ashensori, i cili është në përdorim të vazhdueshëm dhe i nënshtrohet një shkalle të lartë amortizimi, te qiramarrësi, krahas përgjegjësisë për mirëmbajtjen, transferohet edhe përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga përdorimi i tij. Më tej, në analizë të neneve 802 dhe 805 të KC-së, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se lënia e ndërtesës dhe e objekteve të lidhura me të në posedimin dhe gëzimin e qetë e të pandërprerë të qiramarrësit nuk e zhvesh pronarin nga detyrimet që lidhen me kontrollin dhe mirëmbajtjen e strukturave përbërëse të saj, ndërsa qiramarrësi përgjigjet për mirëmbajtjen e zakonshme dhe duhet të njoftojë pronarin për riparimet që nuk janë në ngarkim të tij.

7. Gjykata e Lartë në vijim ka interpretuar edhe pikën 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011, duke vlerësuar se përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga një produkt ose instalim, sikurse është ashensori, i përket, sipas rastit, titullarit të së drejtës së pronësisë ose personit që e ka atë në gëzim të përkohshëm, nëse ky i fundit, mbi bazën e një marrëveshjeje me pronarin, ka marrë përsipër detyrimin për garantimin e përputhshmërisë së tij me kërkesat e detyrueshme të sigurisë. Në rastin konkret, ajo ka çmuar se, në kohën e ngjarjes, subjekti i interesuar ishte titullar vetëm *de iure* i tagrit të disponimit të sendit objekt qiraje, ndërsa ndërtesa dhe objektet e lidhura me të posedoheshin *de facto* prej një kohe të gjatë dhe të vazhdueshme nga shoqëritë qiramarrëse. Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë ka marrë në konsideratë edhe efektin e klauzolës së kontratës së qirasë të lidhur me shoqërinë “Derrigal” sh.p.k., sipas së cilës kësaj të fundit i ishte dhënë e drejta të montonte, me shpenzimet e veta, një ashensor të ri për ngritjen e mallrave. Nga kjo klauzolë ajo ka nxjerrë përfundimin se qiramarrësi kishte dijeni për parregullsinë e ashensorit ekzistues dhe kishte dakordësuar me pronarin montimin e një ashensori të ri, për të cilin ky i fundit kishte dhënë miratimin. Po kështu, në referim të VKM-së nr. 1056/2015, Gjykata e Lartë ka evidentuar se regjistrimi dhe mirëmbajtja e ashensorit janë detyrime të personit përgjegjës, të përcaktuar sipas pikës 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011.

8. Në përfundim, duke zbatuar në mënyrë të ndërthurur këto parashikime në raport me rrethanat konkrete të rastit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se, në mungesë të një sinjalizimi të posaçëm që kufizonte përdorimin e ashensorit vetëm për mallra, ai prezumohej se ishte vënë në shërbim të të tretëve ose të publikut. Ajo ka arritur në përfundimin se përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga të metat e instalimit i përkiste subjektit që kishte në posedim dhe gëzim ndërtesën ku ai ishte instaluar, për sa kohë mbi këtë subjekt rëndonte detyrimi për garantimin e përputhshmërisë së instalimit me kërkesat e detyrueshme të sigurisë dhe ai ushtronte, sipas kontratës së qirasë, pushtetin e gëzimit efektiv. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka çmuar se gjykata e apelit nuk kishte trajtuar në përputhje me ligjin përgjegjësinë e subjekteve që gëzonin ndërtesën nëpërmjet kontratave të qirasë dhe ka vlerësuar të bazuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se nuk provoheshin veprime ose mosveprime të paligjshme të subjektit të interesuar dhe as lidhja shkakësore ndërmjet sjelljes së tij dhe dëmit të ardhur.

9. Në ankimin e tyre kushtetues individual, kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi ka vepruar përtej kompetencave të saj si gjykatë ligji, duke rivlerësuar dhe rikualifikuar faktet e çështjes mbi bazën e të njëjtave prova të administruara nga gjykatat e faktit. Sipas tyre, Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi atë të gjykatës së shkallës së parë, jo për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material ose procedural, por duke i dhënë një vlerësim të ndryshëm rrethanave që lidheshin me administrimin e mjediseve dhe përgjegjësinë për dëmin. Po kështu, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit substancial në gjykatë* të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi, sipas tyre, mënyra e disponimit të Gjykatës së Lartë u ka mohuar të drejtën për të kërkuar përcaktimin e përgjegjësisë dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga humbja e jetës të të afërmit të tyre. Në këtë drejtim, ata kanë parashtruar se, nëse Gjykata e Lartë do të vlerësonte se hetimi gjyqësor nuk ishte kryer në mënyrë të plotë, se çështja kërkonte hetime të mëtejshme ose që provat duhej të rivlerësoheshin për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore, ajo duhej ta kthente çështjen për rishqyrtim dhe jo të linte në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Po kështu, kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje kundërshtimit të tyre për refuzimin nga gjykata e shkallës së parë të kërkesës për thirrjen në gjykim, në cilësinë e palëve të paditura, edhe të dy shoqërive qiramarrëse, kërkesë që, sipas tyre, mbështetej në nenin 161, shkronja “c”, të KPC-së. Së fundi, kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës*, duke i lidhur këto pretendime me prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe humbjen e dëmshpërblimit të njohur prej tij.

10. Shumica, pasi i ka vlerësuar si haptazi të pabazuara pretendimet për cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës së pronës*, ka çmuar se argumentet për cenimin e së

drejtës së aksesit substancial dhe të standardit të arsytimit të vendimit ishin të ndërlidhura me pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Për rrjedhojë, ajo ka vendosur t'i shqyrtojë ato në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, si dhe të pasojave të mundshme për respektimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (*shih paragrafin 24 të vendimit*). Në këtë drejtim, shumica ka përcaktuar se kontrolli kushtetues do të përqendrohej në verifikimin nëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga Gjykata e Lartë përmbanin elemente arbitraret, si dhe nëse ajo e ka gjykuar çështjen pa krijuar dyshime edhe për respektimin e kompetencave të saj (*shih paragrafin 29 të vendimit*).

11. Në vijim, shumica ka vlerësuar se, ndonëse Gjykata e Lartë e ka bazuar analizën e saj mbi të njëjtat fakte dhe prova të administruara gjatë gjykimit në gjykatat e faktit, përfundimi i saj për përjashtimin e përgjegjësisë së pronarit mbështetet në një interpretim të kontratave të qirasë, i cili nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e tyre (*shih paragrafin 34 të vendimit*). Sipas shumicës, nga këto kontrata nuk rezultonte që qiramarrësit të kishin marrë përsipër detyrimin për garantimin e përputhshmërisë së ashensorit ekzistues me kërkesat e detyrueshme të sigurisë, në kuptim të pikës 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011. Po kështu, ashensori ku kishte ndodhur aksidenti ishte pjesë e ndërtesës që prej vitit 1977 dhe jo një instalim i ri i realizuar nga qiramarrësit. Megjithatë, sipas shumicës, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se përgjegjësia ishte transferuar tek ata vetëm mbi bazën e posedimit dhe përdorimit të ndërtesës, pa identifikuar bazën kontraktore ose ligjore që e justifikonte këtë përfundim dhe pa analizuar nëse ai mbështetej në parashikimet konkrete të kontratave të qirasë, si dhe në rrethanën se ashensori përbënte një pjesë ekzistuese të ndërtesës në pronësi të subjektit të interesuar dhe se ai ka pasur mundësinë e parashikimit të pasojave që mund të vinin prej kësaj situatë në kushtet kur nuk ishte montuar një ashensor i ri nga qiramarrësi (*shih paragrafin 35 të vendimit*).

12. Shumica ka vënë në dukje gjithashtu se vetë Gjykata e Lartë ka pranuar dijeninë e pronarit për gjendjen e ashensorit ekzistues, për sa kohë qiramarrësi kishte dakordësuar me të ndërtimin e një ashensori të ri. Megjithatë, sipas shumicës, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar ndikimin e kësaj rrethane në përcaktimin e përgjegjësisë së pronarit dhe as nuk ka shpjeguar se përse miratimi për instalimin e një ashensori të ri konsiderohej i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se detyrimi për garantimin e sigurisë së ashensorit ekzistues ishte transferuar te qiramarrësit (*shih paragrafin 36 të vendimit*). Për rrjedhojë, sipas shumicës, interpretimi i kontratave të qirasë nga Gjykata e Lartë nuk harmonizohet me përmbajtjen objektive të tyre, në kuptimin që nuk analizon në mënyrë shteruese detyrimet e të gjitha palëve në ato kontrata, si dhe nuk mbështetet në faktet e pranuar prej saj dhe nga gjykatat e faktit, duke bërë që përfundimi për përjashtimin e përgjegjësisë së pronarit të mos jetë rezultat i një analize të plotë

dhe logjikisht të lidhur të dispozitave kontraktore dhe ligjore të zbatueshme (*shih paragrafin 37 të vendimit*).

13. Po kështu, shumica ka çmuar se Gjykata e Lartë, megjithëse ka arritur në përfundimin se përgjegjësia për dëmin zhvendosej te shoqëritë qiramarrëse, nuk ka shpjeguar se përse ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili kishte refuzuar thirrjen e tyre në gjykim. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit të kërkuësve për refuzimin nga gjykata e shkallës së parë të kërkesës për thirrjen në gjykim edhe të dy shoqërive qiramarrëse. Gjithashtu, Gjykata e Lartë, edhe pse ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, nuk ka analizuar se përse është i gabuar arsyetimi i kësaj gjykate për përgjegjësinë solidarë të shoqërisë pronare dhe të dy shoqërive qiramarrëse në shkaktimin e dëmit (*shih paragrafin 38 të vendimit*). Për këto arsye, shumica ka arritur në përfundimin se interpretimi jo i plotë i kontratave të qirasë dhe mosdhënia e një përgjigjeje për përgjegjësinë solidarë kanë çuar në një zbatim të ligjit që nuk mbështetet në elementet objektive të çështjes dhe, për pasojë, në një vendimmarrje me elemente arbitrariteti në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të jurisprudencës kushtetuese. Për rrjedhojë, sipas shumicës, pretendimi i kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është i bazuar (*shih paragrafin 39 të vendimit*).

14. Për shqyrtimin e pretendimeve kushtetuese të kërkuësve, vlerësojmë se pikënisja e analizës duhet të jetë përcaktimi i kufijve që burojnë nga natyra subsidiare e kontrollit kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore, sipas standardeve të pranuar edhe nga shumica. Interpretimi i ligjit, përcaktimi i normave të zbatueshme dhe vlerësimi i pasojave juridike të fakteve të çështjes u përkasin, si rregull, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata nuk vepron si një shkallë e katërt gjykimi dhe kontrolli kushtetues përligjet kur gabimi ligjor ose faktik është aq i dukshëm sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ose kur interpretimi i dhënë është arbitrar, haptazi i paarsyeshëm dhe, si i tillë, e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, çështja që shtrohet për vlerësim nuk është nëse interpretimi i dhënë nga Gjykata e Lartë ishte juridikisht më i drejti ndër disa interpretime të mundshme, por nëse ky interpretim kishte kapërcyer kufijtë e interpretimit gjyqësor të arsyeshëm, duke marrë karakter arbitrar dhe duke cenuar drejtësinë e procesit.

15. Për sa i përket së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, jurisprudenca kushtetuese ka dalluar ndërmjet rivlerësimit të fakteve dhe provave, nga njëra anë, dhe kontrollit të zbatimit të ligjit mbi bazën faktike të përcaktuar gjatë gjykimeve të faktit, nga ana tjetër. Gjykata e Lartë nuk mund të përcaktojë fakte të reja, të bëjë vlerësim të ndryshëm të provave të administruara ose të nxjerrë përfundime faktike të kundërta me ato të gjykatave të faktit. Kur ajo çmon se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për

zgjidhjen e çështjes ose që nevojiten vlerësime të mëtejshme faktike, nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës së faktit, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim. Megjithatë, procesi nuk konsiderohet i parregullt kur ajo, mbi të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara gjatë gjykimeve të mëparshme, prish vendimin e gjykatës së apelit dhe e zgjidh çështjen përfundimisht për shkak të interpretimit ose zbatimit të gabuar të ligjit, me kusht që zgjidhja të mos kërkojë ripërcaktimin e fakteve ose rivlerësimin e provave. Në rastin kur gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për faktet thelbësore të çështjes, Gjykata e Lartë nuk mund të përzgjedhë se cili prej këtyre qëndrimeve duhet të merret për bazë dhe, mbi të, ta zgjidhë çështjen përfundimisht. Në këtë kuadër, kontrolli i saj mbetet i përqendruar në ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të ankimuara (*shih vendimet nr. 14, datë 25.03.2025; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 10, datë 03.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë nuk ka administruar prova të reja dhe as ka përcaktuar fakte të reja që nuk ishin shqyrtuar nga gjykatat më të ulëta. Cilësia e subjektit të interesuar si pronar i ndërtesës, ekzistenca dhe gjendja e ashensorit të mallrave, dhënia me qira e mjediseve, posedimi dhe përdorimi i mjediseve nga shoqëritë qiramarrëse për ushtrimin e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe përmbajtja e klauzolës kontraktore për montimin e një ashensori të ri kanë qenë pjesë e bazës faktike dhe provuese të administruar në gjykimet e faktit. Mbi këtë bazë, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar pasojat juridike që këto rrethana prodhonin në drejtim të përgjegjësisë civile, duke kontrolluar mënyrën sesi gjykata e apelit kishte interpretuar dhe zbatuar nenet 623, 802 dhe 805 të KC-së, pikën 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011 dhe kuadrin nënligjor për sigurinë e ashensorëve. Për rrjedhojë, në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë nuk ka ndryshuar bazën faktike të mosmarrëveshjes, por u ka dhënë rrethanave të pranuar një cilësim juridik të ndryshëm nga gjykata e apelit, nëpërmjet interpretimit të ndërthurur të normave juridike të zbatueshme.

17. Vlerësojmë se rrethana që gjykatat e faktit kanë arritur në përfundime të ndryshme nuk nënkupton vetvetiu se Gjykata e Lartë, duke vlerësuar të drejtë zgjidhjen e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, ka përzgjedhur ndërmjet dy varianteve faktike. Vendimet e këtyre gjykatave mbështeteshin, në thelb, në të njëjtën bazë faktike, ndërsa ndryshonin për pasojat juridike që buronin prej saj. Dallimi ndërmjet tyre lidhej, në thelb, me mënyrën sesi cilësia e pronarit, posedimi efektiv nga qiramarrësit, detyrimet për mirëmbajtjen dhe përmbajtja e kontratave të qirasë ndikonin në identifikimin e personit përgjegjës. Gjykata e Lartë ka pranuar bazën faktike të përcaktuar nga gjykatat e faktit dhe u ka dhënë rrethanave të pranuar një cilësim juridik që përputhej me zgjidhjen e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se gjykata e apelit kishte interpretuar dhe zbatuar gabim ligjin. Në vlerësimin tonë, një mënyrë e tillë kontrolli është në pajtim me funksionin rishikues të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, për

sa kohë zgjidhja e çështjes nuk ka kërkuar një hetim të ri gjyqësor ose rivlerësim të provave, por verifikimin e cilësimit juridik të rrethanave të pranuar.

18. Në këtë këndvështrim, në vlerësimin tonë, interpretimi i Gjykatës së Lartë nuk paraqitet i shkëputur nga normat dhe rrethanat e çështjes. Ajo ka pranuar, fillimisht, rregullin e përgjegjësisë së pronarit sipas nenit 623 të KC-së. Më pas ka analizuar ndarjen e detyrimeve ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit sipas neneve 802 dhe 805 të këtij kodi, si dhe ka interpretuar konceptin e personit përgjegjës sipas pikës 24 të nenit 3 të ligjit nr. 10489/2011. Në vijim, ajo ka vlerësuar edhe efektin juridik të posedimit faktik të mjediseve, të përdorimit të vazhdueshëm të instalimit dhe të klauzolës kontraktore për montimin e një ashensori të ri. Mbi bazën e kësaj analize, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se, në rrethanat konkrete, përgjegjësia lidhej me subjektet që ushtronin pushtetin e gëzimit efektiv mbi mjediset dhe instalimin, mbi të cilat rëndonin detyrimet përkatëse të mirëmbajtjes dhe të sigurisë. Edhe nëse ky interpretim mund të ngrejë diskutime në planin e së drejtës civile, ai nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar në kuptimin kushtetues. Kontrolli kushtetues nuk synon të përcaktojë interpretimin më të përshtatshëm të ligjit të zakonshëm, por të verifikojë nëse interpretimi i dhënë ka kapërcyer kufijtë e interpretimit gjyqësor të arsyeshëm dhe ka cenuar drejtësinë e procesit.

19. Në funksion të vlerësimit të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, çështja që shtrohet është nëse mungesa në kontratat e qirasë e një klauzole të shprehur për transferimin të qiramarrësit të detyrimit për garantimin e sigurisë së ashensorit ekzistues e bënte përfundimin e Gjykatës së Lartë të pambështetur ose arbitrar. Në vlerësimin tonë, një përfundim i tillë nuk mund të nxirret vetëm nga mungesa e një parashikimi të shprehur kontraktor. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se detyrimet e qiramarrësve dhe përgjegjësia për dëmin duhej të përcaktoheshin nga interpretimi i ndërthurur i marrëdhënies së qirasë, i ndarjes ligjore të detyrimeve ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit, i posedimit dhe i administrimit faktik të mjediseve, i natyrës dhe përdorimit të instalimit, si dhe i dispozitave të legjislacionit për sigurinë e produkteve. Çështja nëse nga këto elemente mund të nxirrej, edhe në mënyrë të nënkuptuar, detyrimi i qiramarrësve për mirëmbajtjen dhe garantimin e sigurisë së instalimit i përkiste interpretimit të së drejtës së zakonshme. Për sa kohë Gjykata e Lartë ka paraqitur elementet juridike dhe faktike mbi të cilat e ka mbështetur këtë interpretim, mungesa e një klauzole të shprehur nuk është e mjaftueshme *per se* për ta konsideruar arsytimin e saj haptazi të paarsyeshëm ose arbitrar në kuptimin kushtetues.

20. Për sa i përket dijenisë së pronarit për gjendjen e ashensorit, vlerësojmë se kjo rrethanë nuk është lënë jashtë arsytimit të Gjykatës së Lartë. Sipas jurisprudencës kushtetuese, detyrimi për respektimin e standardit të arsytimit të vendimit nuk nënkupton dhënien e një

përgjigjeje të detajuar për çdo pretendim të palëve, përveçse kur ai është përcaktues për zgjidhjen e çështjes, ndërsa shkalla e arsyetimit varet edhe nga natyra e vendimit (*shih vendimet nr. 7, datë 20.02.2025; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka analizuar klauzolën që lejonte shoqërinë “Derrigal” sh.p.k. të montonte një ashensor të ri dhe prej saj ka nxjerrë përfundimin se qiramarrësi kishte dijeni për parregullsinë e ashensorit ekzistues dhe se ndërmjet tij dhe pronarit kishte një dakordësi për zëvendësimin e instalimit. Kjo rrethanë është vlerësuar së bashku me posedimin dhe përdorimin e vazhdueshëm të mjediseve, detyrimin e qiramarrësit për mirëmbajtjen e zakonshme, si dhe detyrimin për të njoftuar qiradhënësin për riparimet që nuk ishin në ngarkim të tij. Fakti që Gjykata e Lartë i ka dhënë dijenisë së pronarit dhe klauzolës kontraktore një pasojë juridike të ndryshme nga gjykata e apelit, nuk përbën, në vetvete, mungesë arsyetimi. Nga vendimi kuptohet se përse, në vlerësimin e saj, këto rrethana nuk mjaftonin për ta ngarkuar subjektin e interesuar me përgjegjësi për dëmin.

21. Po kështu, në vlerësimin tonë, përfundimi i Gjykatës së Lartë për mungesën e përgjegjësisë së shoqërisë pronare të ndërtesës përmban edhe përgjigjen thelbësore ndaj arsyetimit të gjykatës së apelit për përgjegjësinë solidare. Solidariteti i pranuar nga kjo e fundit mbështetet në premisën se edhe pronari ishte një nga subjektet përgjegjëse për shkaktimin e dëmit. Me përjashtimin e përgjegjësisë së pronarit, si rezultat i interpretimit të dispozitave ligjore dhe kontraktore, binte edhe baza mbi të cilën ishte mbështetur përgjegjësia solidare e tij me qiramarrësit. Për rrjedhojë, moszhvillimi i një analize të veçantë për solidaritetin nuk e bën vendimin e Gjykatës së Lartë të paarsyetuar, për sa kohë mospranimi i këtij përfundimi del qartë nga arsyetimi i përgjithshëm dhe nga përjashtimi i një prej kushteve mbi të cilat ai ishte ndërtuar.

22. Për sa i përket pretendimit që lidhet me refuzimin nga gjykata e shkallës së parë të kërkesës për thirrjen në gjykim të shoqërive qiramarrëse, vlerësojmë se ai është ngritur në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Megjithatë, shqyrtimi i tij kërkon që të përcaktohet paraprakisht nëse kjo çështje përfshihej në kufijtë e shqyrtimit të Gjykatës së Lartë. Sipas nenit 473/a të KPC-së, Gjykata e Lartë e shqyrton rekursin brenda kufijve të tij, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Ndërkohë, sipas nenit 477 të këtij kodi, pala kundër së cilës është paraqitur rekursi mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs. Nga interpretimi i ndërthurur i këtyre dispozitave rezulton se kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë përcaktohen nga shkaqet e rekursit, ndërsa kundërrekursi ka funksionin e kundërshtimit të tyre dhe nuk mund t'i zgjerojë kufijtë e shqyrtimit me çështje të tjera që nuk janë ngritur në rekurs. Kur pala synon të kundërshtojë në mënyrë të pavarur një pjesë të vendimit të gjykatës së apelit, një kundërshtim i tillë nuk mund të parashtrohet përmes kundërrekursit, por u nënshtrohet rregullave që zbatohen për rekursin. Në këtë drejtim,

jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se neni 473/a i KPC-së mishëron parimin procedural *non ultra petita partium* dhe përcakton kufijtë e juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë. Sipas këtij parimi, ajo nuk mund të shqyrtojë çështje të ligjit që nuk janë ngritur në rekurs, përveç rasteve kur ligji parashikon shprehimisht ndryshe, ndërsa zgjerimi i shqyrtimit përtej këtyre kufijve mund të vërë në diskutim respektimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (*shih vendimet nr. 39, datë 17.06.2025; nr. 55, datë 07.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, ndërsa kërkuesit e kanë kundërshtuar atë me kundërrekurs. Në rekurs, subjekti i interesuar ka kundërshtuar, ndër të tjera, formimin e ndërgjyqësisë dhe legjitimitimin e tij pasiv. Me kundërrekurs, kërkuesit kanë kundërshtuar, në funksion të rrëzimit të rekursit, këto shkaqe dhe kanë mbrojtur zgjidhjen e dhënë nga gjykata e apelit për përgjegjësinë e shoqërisë pronare. Për rrjedhojë, argumentet e tyre për refuzimin e thirrjes së shoqërive qiramarrëse mund të merreshin në konsideratë vetëm për atë sa shërbenin për kundërshtimin e shkaqeve të rekursit që lidheshin me legjitimitimin pasiv dhe formimin e ndërgjyqësisë. Nga ana tjetër, në vlerësimin tonë, në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, këto argumente nuk mund ta investonin Gjykatën e Lartë për të shqyrtuar, si çështje autonome, ligjshmërinë e refuzimit të zgjerimit të ndërgjyqësisë nga gjykata e shkallës së parë, për sa kohë ligjshmëria e këtij refuzimi nuk ishte ngritur në rekurs si çështje më vete. Duhet mbajtur parasysh gjithashtu se shoqëritë qiramarrëse nuk kanë qenë palë në proces. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë nuk mund të përcaktonte me efekt detyrues përgjegjësinë e tyre civile, por vetëm të vlerësonte, në funksion të kërimit të ngritur ndaj palës së paditur, nëse rrethanat që lidheshin me posedimin dhe përdorimin e mjediseve nga këto shoqëri ndikonin në ekzistencën e përgjegjësisë së shoqërisë pronare. Në këtë kuptim, çështja e vendosur përpara Gjykatës së Lartë, për sa i përket këtij aspekti të mosmarrëveshjes, ishte nëse shoqëria “Pro-Plast” sh.p.k., ndaj së cilës ishte drejtuar padia, mbante përgjegjësi civile për dëmin. Për këtë kërkim Gjykata e Lartë ka dhënë përgjigje, duke interpretuar kushtet e përgjegjësisë civile dhe marrëdhëniet juridike ndërmjet pronarit dhe qiramarrësve. Për rrjedhojë, në vlerësimin tonë, mungesa e një përgjigjeje të posaçme nga Gjykata e Lartë për refuzimin, nga gjykata e shkallës së parë, të kërkesës për thirrjen e qiramarrësve nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, pasi ligjshmëria e këtij refuzimi nuk përfshihej si çështje autonome në kufijtë e shqyrtimit të përcaktuar nga rekursi dhe nuk ishte përcaktuese për zgjidhjen e kërimit të ngritur ndaj palës së paditur.

24. Në përfundim, vlerësojmë se Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të saj si gjykatë ligji, duke u mbështetur në faktet dhe në provat e administruara nga gjykatat e faktit, dhe duke vlerësuar pasojat juridike që ato prodhonin për përcaktimin e subjektit

përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Vendimi i saj paraqet në mënyrë të kuptueshme kuadrin ligjor, rrethanat e marra në konsideratë dhe lidhjen e tyre me përfundimin e arritur. Interpretimi i dhënë nga Gjykata e Lartë nuk paraqitet haptazi i gabuar, kontradiktor ose i tillë që një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë. Verifikimi i përmbajtjes dhe i pasojave juridike të kontratave të qirasë, i peshës juridike të posedimit dhe administrimit të objektit, si dhe i mënyrës së plotësimit të kushteve të përgjegjësisë civile, për sa kohë nuk evidentohet një interpretim arbitrar, u përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Një kontroll kushtetues që do të përcaktonte vetë interpretimin juridik më të përshtatshëm të këtyre elementeve do ta vendoste Gjykatën në pozitën e një shkalle të katërt gjykimi, në kundërshtim me natyrën subsidiare të juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, nuk rezulton se mënyra e shqyrtimit dhe e zgjidhjes së çështjes nga Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e kërkuësve për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj ose të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këto kushte, mbajtëm qëndrimin se kërkesa duhej të ishte rrëzuar.

Anëtarë: Sandër Beci, Ilir Toska, Asim Vokshi